



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:018530

Datë: 31.03.2021

Numri i dokumentit: 01653463

P.nr.56/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega Viti, Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtarës Blerina Jakupi Ramadani, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurve NN nga Vitia, rr."Flaka e Janarit", me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Ekrem Pira dhe NN nga Vitia, rr.Flaka e Janarit" me mbrojtësen sipas autorizimit av. Malsore Halili, për shkak të veprës penale: në bashkëveprim lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, nënparag.1.3 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe të pandehurit NN nga fshati Gërmovë K. Viti, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par.1, nënparag. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), sipas aktakuzës të PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr.153/2021 e dt.04.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e jopublik të dt. 25.03.2021, me datën 25.03.2021 mori, shpalli publikisht dhe me dt. 31.03.2021, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri NN nga babai NN, nëna NN, e lindur NN, i lindur me dt. 27.03.1992, në Gjilan, tani me vendbanim ne Viti rruga "Flaka Janarit, i pa martuar, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së varfer ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal: 1231042390.

I pandehuri NN nga babai NN, nëna NN, e lindur NN, i lindur me dt. 06.05.1996, në Gjermani, tani me vendbanim ne Viti rruga "Flaka Janarit, i pa martuar, ka të kryer fakultetin, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal: 1241742314.

J A N Ë F A J T O R

Sepse

- Më date 05.01.2021, rreth orës 17:20 min, në Viti, në rr." Brigada 173", në objektin ku i dëmtuari NN, mban kurs të gjuhës gjermane, të pandehurit NN dhe NN, në bashkëveprim me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor të dëmtuarit

NN, kanë lënduar rëndë të njëjtin në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale rreth aplikimit të gabuar të dëmtuarit për një kurs të gjuhës në Institutin “Goethe”, pa pëlqimin e të pandehurve fillon një fjalosje verbale e dyanshme me komunikim të tensionuar, me ç’rast i dëmtuari NN e shtyn me duar të pandehurin NN dhe kapen për rroba fillimisht, e më pas përfshihen në një konflikt fizik të dyanshëm, ku të pandehurit NN dhe NN e godasin fizikisht të dëmtuarin NN me grushte në fytyrë dhe në pjesën e epërme të trupit, me ç’rast i dëmtuari NN pëson lëndime të rënda trupore në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të hundës, thyerje e kockës së hundës, gjakderdhje nga hunda si pasojë e traumës të evidentuara në raportin mjekësor nr.312, të dt. 05.01.2021, që sipas ekspertizës konstatohen si dëmtime të rënda trupore.

- me këtë kanë kryer veprën penale: në bashkëveprim lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, nënparag.1.3 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës),

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,40,42,44,69 dhe 70 të KPRK, si dhe nenit 247 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

E GJYKON

I.Ashtu që të akuzuarit NN për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i caktohet denim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh, ashtu që denimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëqlimin e të denuarit, gjykata ka vendosur që denimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, të njëjtit t’i zëvendësohet me denim me gjobë në shumë prej 1 200€ (njëmijëedyqind) €, të cilin denim i pandehuri do ta paguaj në afat në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

II.Ashtu që të akuzuarit NN për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i caktohet denim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh, ashtu që denimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm

Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëqlimin e të denuarit, gjykata ka vendosur që denimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, të njëjtit t’i zëvendësohet me denim me gjobë në shumë prej 1 200€ (njëmijë e dyqind) €, të cilin denim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë denimin me gjobë me denim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të denimit me gjobë.

I dëmtuari NN për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të pandehurit që në mënyrë solidare të paguajë shumën prej 20 (njëzet) € për ekspertizë mjeko-ligjore, paushallin gjyqësore ne shumën prej 20€ (njëzet) euro dhe shumën

prej 30€ (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rjedha e çështjes

Prokuroria Themelore nga Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, me datën 09.02.2021 ka ngritur aktakuzën me numer PP.II.nr.153/2021 e dt.04.02.2021, kundër të pandehurve pandehurve NN nga Vitia, rr."Flaka e Janarit" dhe NN nga Vitia, rr.Flaka e Janarit", për shkak të veprës penale: në bashkëveprim lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, nënparag.1.3 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës) dhe të pandehurit NN nga fshati Gërmovë K. Viti, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par.1, nënparag. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës).

Në këtë lëndë penale gjyqtarja e çështjes pas dëgjimit të palëve ka bërë veqimin e lëndës ndaj të pandehurit NN, pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar, ndërsa të pandehurit NN dhe NN kanë arritur marrëveshje për pranimit të fajësisë me prokurorin e shtetit.

Me datë 25.03.2021 është mbajtur shqyrtimi fillestar, në të cilin kanë prezentuar prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri dhe të pandehurit NN, me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Ekrem Pira dhe NN, me mbrojtësen sipas autorizimit av. Malsore Halili.

Me datë 23.03.2021, prokuroria ka dorëzuar Marrëveshjet mbi Pranimin e Fajësisë të datës 19.03.2021, të arritur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurve NN, me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Ekrem Pira dhe NN, me mbrojtësen sipas autorizimit av. Malsore Halili, sipas së cilës marrëveshje kësaj gjykate i është rekomanduar që të pandehurve për shkak të veprës penale të lartcekur t'i shqiptohet secilit veq e veq denim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh, ashtu që denimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëqlimin e të pandehurve gjykata ka vendosur që denimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, të njëjtëve t'i zëvendësohet me denim me gjobë, secilit veq e veq në shumë prej 1 200€ (njëmijë e dyqind) euro, të cilin denim të pandehurit do ta paguajnë në afa prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, ku në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë të mbajtur me datë 25.03.2021, prokurorja e shtetit dhe të pandehurit me mbrojtësit e tyre kanë mbetur në tërësi pranë të njëjtës.

2.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Gjykata më date 25.03.2021 ka mbajtur seancën dëgjimore lidhur me marrëveshje për pranimin e fajësisë, në të cilën kanë qenë prezent prokurorja e shtetit, të pandehurit me mbrojtësit e tyre, ku pas dëgjimit të palëve gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në bazë të nenit 247 parag.1 te KPRK-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe të pandehurve të lartcekur, i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 233 të KPRK-ës, po ashtu gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë

edhe ate: deklaratat e të pandehurve NN dhe NN, NN, deklarata e dëshmitarit NN, raporti mjekësor i dt. 032/861, i dt. 05.01.2021, lëshuar nga Shtëpia e Shëndetit në Viti dhe nr. 334, i dt. 05.01.2021, lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit – Emërgjenca në emër të të pandehurit NN, raporti mjekësor n.312, i dt. 05.01.2021, lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit-Emërgjenca, në emër të të pandehurit NN, CD nga vendi i ngjarjes, fotodokumentacioni, ekspertizat mjekoligjore me nr. të ref. 20/01/21, të dt. 28.01.2021, raporti i oficerëve, foto nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera të lëndës si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPPRK-së.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartëcekurat, gjyqtarja e vetme gjykuese vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit NN dhe NN kanë kryer veprën penale: në bashkëveprim lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, nënparag.3 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), në vendin dhe mënyrë e përshkruar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi,

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata në rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 71 paragrafi 1 , nën paragrafi 3 të KPRK-së ka vlerësuar që të pandehurve t'i shqiptohet secilit veq e veq denim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh, ashtu që denimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së dhe me pëqlimin e të pandehurve gjykata ka vendosur që denimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, të njëjtëve t'i zëvendësohet me denim me gjobë, secilit veq e veq në shumë prej 1 200€ (njëmijë e dyqind) euro, të cilin denim të pandehurit do ta paguajnë në afa prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat që gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit.

Gjithashtu gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se të pandehurit kanë ariitur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ne Prokurorinë Themelore në Gjilan, kanë shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, janë penduar dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale.

5. Shqipimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe më shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së gjyqtares së vetme gjykuese dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve NN dhe NN, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënimi i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve.

Gjyqtarja po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-ës i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale,shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e ligjit.

6.Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 43 parag.3 të KPRK-ës nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për cdo 20 euro (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

7. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike

Gjykata duke u bazuar në neni 463 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurve gjyqtarja e vetme gjykuese duke u bazuar në nenin 451 parag.1 të KPP-së ka vendosur që të pandehurit t'i obligojë në mënyrë solidare t'a paguajën shumën për ekspertizë mjekoligjore, në vlerë prej 20 (njëzet) € dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 euro, si dhe shumen prej 30 euro për kompenzimin e viktimave të krimit edhe atë në kuptim të nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimit si dhe shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega VITI

P.nr.56/21

31.03.2021

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Blerina Jakupi Ramadani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.